



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Tel. 00355 84 63408  
e-mail: [rektori@uogj.edu.al](mailto:rektori@uogj.edu.al)  
[http www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

Gjirokastrë, më 27/10/2016

VENDIM  
Nr. 29 datë 27.10.2016

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 467, datë 18.07.2007  
"Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e  
pedagogjik të personelit akademik" Senati Akademik i Universiteti "Eqrem Çabej"  
Gjirokastrë në mbledhjen e tij të datës 27.10.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e një grupi profesorësh të Fakultetit të Edukimit dhe  
Shkencave Shoqërore për dhënien e titullit "**Doctor Honoris Causa**", **Prof. dr.**  
**Agron Ficos**.

Me motivacionin:

*"Intelektual i spikatur gjirokastrit me një veprimtari të pasur kërkimore e  
shkencore mbi 50 vjeçare, me interesa të gjera në fushën e shkencës; albanolog,  
gjuhëtar, studiues i etnokulturës, i dalluar në mënyrë të veçantë në promovimin  
dhe mësimin e gjuhës shqipe nga të huajt; autor botimesh të shumta në sferën e  
problemeve albanologjike, studiues i njohur në botën shqiptare, në diasporë, në  
SHBA e më gjerë, i cili falë punës së tij profesionale, vullnetit dhe pasionit të  
vazhdueshëm si dhe vizioneve bashkëkohore, ka bërë të mundur realizimin e  
prurjeve shkencore të rëndësishme në vite, kryesisht në studimin dhe interpretimin  
e etnokulturës, folklorit, gjuhësisë shqiptare".*

2. T'i propozojë Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, pranë Ministrisë  
së Arsimit dhe Sportit për dhënien e pëlqimit për akordimin e titullit të mësipërm.

Prof.dr.Bektash MEMA

KRYETARI I SENATIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 37 Prot. b

Datë 07. 05. 2018

**VENDIM**

**Nr 08, datë 07. 05. 2018**

**MIRATIMI I DHËNIES SË TITULLIT HONORIS CAUSA  
AKADEMIKUT SHABAN SINANI**

Në zbatim të ligjit nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 60 pika 3 dhe neni 79 pika 7, si dhe VKM-së nr 112 datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" kreu IV pika 1, vendimit të Rektoratit nr. 09 datë 16.04.2018, Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 07.05.2018 ;

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e titullit "HONORIS CAUSA" akademikut Shaban Sinani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

*M. Bektash*  
**Prof.dr. Bektash MEMA**



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

SENATI AKADEMIK

Nr 473 Prot.

Gjirokastrë, më 18 / 03 / 2019

V E N D I M

Nr 09, datë 18.03.2019

PËR PROF. DR ARBEN MALAJ

Në zbatim VKM nr. 112, datë 23.02.2019 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" kreu V pika 1, Senati Akademi në mbledhjen e tij të datës 18.03.2019 diskutoi për akordimin e titullit akademik "Doktor Honoris Causa" prof.dr. Arben Malaj, pas propozimit dhe motivacionit të ardhur nga FE si dhe pas pëlqimit të dhënë nga MASR me shkresën nr. 10184/1, datë 10.01.2019 dhe

VENDOSI

1. T'i akordoje titullin "Doktor Honoris Causa" prof.dr. Arben Malaj me motivacionin:

Personalitet me veprimtari të shquar akademike-universitare dhe kërkimore-botuese; protagonist i suksesshëm prej dekadash në fushën e ekonomisë e të financave; ligjvënës e shtetar me stimë popullore të gjerë; kërkues vizionar dhe kontribues i suksesshëm në mësimdhënien e disiplinave ekonomike në universitete shqiptare e të huaja; ligjërues virtuoz i disiplinave të politikës makroekonomike, fiskale dhe të investimeve publike; me kontribute të rëndësishme parësore në përngritjen e cilësisë akademike e të kërkimit shkencor në Universitetin *Eqrem Çabej* të Gjirokastrës, veçanërisht të Fakultetit Ekonomik, mbështetës i nismave dhe projekteve të tij.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA